



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZH D
ZYRA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Adresa : Qyteti Librazhd Nr.Tel & fax. 0514 / 2352,

e-mail: librazhdbashkia@yahoo.com.

RELACION TEKNIK
MBI PROJEKTIN
“RIKUALIFIKIM URBAN I BLOKUT TE BANIMIT NR.1, LIBRAZH D”

BASHKIA LIBRAZH D

Bloku i banimit Nr.1 Librazhd ku kerkojme te nderhyjme , ndodhet në pjesen verilindore të qytetit te Librazhdit. Bloku kufizohet ne jug nga rruga "Jakup Bicaku" dhe rruga gani Blloshmi, ne lindje nga rruga e Gjetes, ne veri nga rruga e spitalit dhe ne perendim nga rruga e Dibres dhe ka nje siperfaqe rreth 6 ha.

Bloku pershkohet nga këto rrugE : rruga " Arberia" , "Qazim Murtini", rruga "Kadri Koxha" , "Shahin Zharri", "Daut Mana" "Rexhep haxhiu".

Ky bllok banimi eshte me ndërtime para viteve 1990 , pallate 3 , 4 e 5 kateshe . Ky bllok banimi eshte mjaft i frekuentuar pasi ketu ndodhen objektet ne funksion te arsimit si shkollat 9-vjecare Genc Leka dhe Vilson Blloshmi, çerdhja e qytetit, kopeshti i femijeve nr.1 ,ndodhet Konsultorja e nenes dhe femijes , Komisariati i policise, Muzeu Etnografik i Rrethit, Dega e Tatim Taksave te rrethit,objekt kulti Xhamia qytetit, etj.

Ky bllok banimi eshte zona lidhese midis qytetit dhe Spitalit .

Ne kete bllok banimi ndertuar ne periudhen 1960-1980 , nuk jane kryer investime ne infrastrukturen inxhinierike.

Te dhena te gjendjes aktuale:

Territori i ketij blloku banimi eshte i degraduar, mungon infrastruktura rrugore, mungon kanalizimi i ujrave te bardha, kanalizimet e ujrave te zeza nuk i pershtaten zhvillimit te bllokut. Brenda bllokut te banimit mungon ndricimi rrugor.

Kerkohet nderhyrje ne rikualifikimin urban te te gjithe territorit te bllokut.

Nderhyrje do te kete edhe ne lirimin e hapesirave publike te zaptuara nga ndertimet pa leje apo rrethimet e kateve te para.

Rikualifikimi Urban

Nderhyrjet kryesore te parashikuara.

Nyja 1

Ndertim i dy mureve mbajtes dhe dekorativ ne kufi me fushen e futbollit. Midis dy mureve eshte parashikuar mbjellja e pemeve dekorative per te riaftesuar gjelberimin e kesaj zone.Rehabilitimi i shkalleve midis terreneve sportive.

Nyja 2

Zgjerimi i rruges kryesore te qytetit rruga "Arberia" dhe rehabilitimi i terrenit ne krah te pallateve 5 kateshe ,nepermejt ndertimit te murit mbajtes dekorativ , krijimit te trotuarit te ri, si dhe mbjelljeve me peme te ulta dekorative. Rehabilitimi total i terrenit ne krah te shkalleve ekzistuese .

Nyja nr.3

Ndertim rruge e re qe lidh rrugen e spitalit me objektet arsimore, dhe rehabilitim i territorit nepermejt ndertimit te rrugicave, lulishteve te reja , parkimeve dhe shesheve per argetim.

Nyja 4

Rehabilitimi i territorit te degraduar, ndertimi i hapësirave per parkim, lulishte dhe argetim.Per shkak te terrenit te thyer nevojitet ndertimi i rrugicave dhe shkallareve per lidhjen me te gjitha objektet e banimit dhe sherbimit

Nyja 5

Rehabilitimi i shesheve midis pallatave 5 kateshe .Sistemimi i rrugeve kryesore te bllokut te banimit.

Nderhyrje te tjera qe jane parashikuar :

- ***Rruget***

Parashikohet rehabilitimi dhe sistemimi i te gjitha rrugeve dhe rrugicave te brendshme te bllokut .Shtresat e rrugeve kryesore automobilistike jane parashikuar me asfaltobeton, rrugicat, trotuaret dhe sheshet e midis pallateve me shtresa guri natyral ose kalldrem.

- ***Trotuaret***

Parashikohet ndertimi i trotuareve te objekteve te banimit ne brendesi te bllokut . Shtrimi eshte parashikuar me shtresa guri natyror dhe me bordura të parafabrikuara ose guri. Në pjesët e ndërprerjes së trotuareve eshte parashikuar ndertimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë-trotuar për personat me aftësi të kufizuar.

- ***Sinjalistika***

Sinjalistika përfshin vizimet me boje bikomponente gjerësi 15 cm.Vendosja e tabelave treguese te rrugeve dhe emertimit te pallateve .

- ***Ndriçimi rrugor***

Ndriçimi rrugor do të bëhet i ri vetem per rruget qe nuk kane ndricim. Eshte parashikuar vendosja e dy lloje shtyllash ndricimi të reja metalike me lartësi H=7 m Pozicioni i vendosjes se tyre eshte i percaktuar ne planimetritë e ndricimit. Llampat e ndriçimit do të jenë me ngjyrë të verdhë me fuqi 250 W. Linja eshte me trase nëntokësore ku do të vendoset tub plastik me dy shtresa me Ø=36 mm për kalimin e kabllit të furnizimit.

Foto te gjendjes aktuale





Procurement
Albania



Pusetat jane prej plastike me përmasa 40x40x40cm me kapak te forte. Distanca ndërmjet pusetave eshte 25 m larg njëra tjetrës dhe jane vendosur mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e mundshme. Panelet e komandimit jane me komandim sauteri me fotoelementë.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori egzistues.


- ***Projekti i ndërtimit të sistemit të kanalizimeve te ujrave te bardha***

Kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza parashikohet te ndertohen te ndara. Kanalizimet e ujrave te bardha parashikohet te realizohen me tub PVC 250 dhe HDPE 315 PE te brinjezuar . Pusetat jane me kapak gize me permasa 40x40 cm dhe jane vendosur cdo 25 m.

- ***Projekti i ndërtimit të sistemit të kanalizimeve te ujrave te zeza***

Nese do te jete e nevojshme kanalizimet e ujrave te zeza parashikohen te realizohen me tubo te brinjezuar SN8 me diameter 315,500, te vendosur ne thellesine 150 cm nen aksin e rruges.Nderhyrja ne rrjetin e KUN te behet ne bashkepunim me sh.a uejsjelles kanalizime Librazhd. Pusetat te jene me kapak gize me diameter 1m .

KRYETARI
KASTRIOT GURRA



**Procurement
Albania**

Specifikimi i cmimeve ne punimet e projektit:
“RIKUALIFIKIM URBAN I BLOKUT TE BANIMIT NR.1, LIBRAZH

BASHKIA LIBRAZH

- ***Germim dhe trup rruge*** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorine qe lidhet me germimin e dheut ne cfaredo lloj toke, makineri apo me krahe, me thellesine e percaktuar ne profilat gjatesore te projektit. Ky cmim perfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen ne vendet e autorizuara per depozitimin e materialeve te teperta te evaduara. Ky cmim i referohet 1 m³ germim.

- ***Shtrese pllaka guri*** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me blerjen ose prodhimin e gurit dekorativ per shtresa rruge, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, hapjen ne veper, sipas kushteve teknike dhe profilit te paraqitur ne projekt. Ky çmim i referohet 1 m².

- ***Germim dheu*** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorine qe lidhet me germimin e dheut ne cfaredo lloj toke, makineri apo me krahe, per hapjen e themeleve ku do te ndertohen muret mbajtes me thellesine e percaktuar ne profilat gjatesore te projektit. Ky cmim perfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen ne vendet e autorizuara per depozitimin e materialeve te teperta te evaduara. Ky cmim i referohet 1 m³ germim.

- ***Mure buto betoni m-150*** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen e betonit ose te materialeve te nevojshme (si rere, granil, cimento, gure, armature dhe cdo gje tjeter) ndertimin e murit buto betonit M-150 ,pergatitjen e armaturave , transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, vibrimin dhe cdo gje tjeter qe lidhet me realizimin e ketij zeri sipas projektit. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjehere me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit. Ky cmim i referohet. 1 m³.

- ***Shtrese stabilizanti 20 cm*** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me blerjen ose prodhimin e cakullit te makinerise, qe duhet te jete gur i thyer dhe jo zhavorr lumi, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, hapjen ne veper dhe rulimin ne lageshtire, sipas kushteve teknike, sipas profilit te paraqitur ne projekt, me trashesi minimale 20 cm sic percaktohet ne preventiv. Kjo shtrese perdoret ne te gjithë gjatesine e rruges. Ky çmim i referohet 1 m².

- ***Shtrese binder 6 cm*** - Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe te punimeve qe lidhen me blerjen/pregatitjen, sperkatjen me nje dore bitum me 1,2 lit/m² te shtreses paraardhese, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, shtrimin me asfalt shtruese, rulimin e shtreses se binderit me trashesi mesatare 5 cm sipas kushteve teknike. Zbatuesi te kete parasysh qe ketu te parashikoje edhe ate volum te nevojshem per ti dhene rruges kurrizin e nevojshem per te garantuar pjerresine e shtreses perfundimtare sic eshte dhene ne projekt. Ky çmim i referohet 1 m².

- ***Shtrese asfaltbetoni 4 cm*** - Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe te punimeve qe lidhen me blerjen/pregatitjen, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, shtrimin me asfalt shtruese, rulimin e shtreses se asfaltbetonit me trashesi mesatare 5 cm sipas kushteve teknike. Ky çmim i referohet 1 m².

- ***F.V. Bordure trotuari 12x25 cm te parapergatitura*** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me prodhimin/blerjen e bordurave te

betonit M- 200 te parapergatitura me permasa 12x25 cm qe vendosen anesh rruges per te kufizuar trotuarin nga rruga, germimi i kanalit per vendosjen e tyre, vendosja e tyre ne veper dhe çdo gje tjeter e nevojshme. Gjithashtu ketu futet edhe kostoja e blerjes, ngarkimit, transportit, shkarkimit, te materialeve te tjera te nevojshme (armature derrase apo metalike, rere, cemento, granil e tjera. Bordurat duhet te jene te stazhonuara mire. Ky çmim i referohet 1 ml.

- **Beton C 16/20** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen e betonit ose te materialeve te nevojshme (si rere, granil, cemento dhe cdo gje tjeter) per prodhimin e betonit C 16/20 qe perdoret si shtrese nden kunete me trashesi 10 cm, transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, pregatitjen e armatures se derrases, vibrimin dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjehere me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit. Ky çmim i referohet. 1 m³.

- **Transport dherash deri ne 3 km**- Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me transportimin e dherave te teperta nga pastrimi i trupit te rruges me auto veteshkarkues deri ne 3 km. Ky çmim i referohet 1 m³.

- **Germim kanali** - Ky çmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me germimin e dheut ne cfaredo lloj toke, makineri apo me krahe, per hapjen e kanaleve ku do te shtrihen tubot e plastike te kablllove elektrike me thellesine e percaktuar ne profilat gjatesore te projektit. Si dhe per hapjen e gropave per vendosjen e shtyllave te ndricimit. Ky çmim perfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen ne vendet e autorizuara per depozitimim e materialeve te teperta te evaduara. Ky çmim i referohet 1 m³ germim.

- **F.V.tuba plastike . d= 63 mm** - Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me blerjen apo prodhimin e materialeve te nevojshme (si tuba plastike. d=80 mm, zhavorr, dhe cdo gje tjeter), shtrirjen e tubave per vendosjen e kablllove elektrike sipas profilit te dhene ne projekt mbi shtresen e reres me trashesi 10 cm, ngjitja e tyre me ngjtese sintetike hidroizoluese apo lidhja me te njejten ngjtese e gotave me kokat e tubave, kostoja e blerjes se ketyre materialeve dhe çdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per funksionimin e kanalizimit, te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt si dhe ngarkimin, transportin, shkarkimin e te gjitha materialeve te permendura me siper, largimin e materialeve te teperta ne pikat e autorizuara nga autoritetet lokale per hedhjen e mbeturinave ndertimore, dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Ky çmim i referohet 1 ml.

- **F.V. kabell elektrik** - Ky çmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per shtrirjen e kablllove (3+1)kablllo 6 mm² dhe 3 me 2.5mm². Ne çmim futet blerja e materialit ,transporti e cdo gje tjeter qe lidhet me te. Ky çmim i referohet 1 ml.

- **F.V. togezues** - Ky çmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per instalimin e togezuesit, blerja e materialeve te nevojshme lektroda xing 50x3mm L=150, morseta etj. Ky çmim i referohet 1 cope.

- **F.V. limitator 25 A** - Ky çmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per instalimin e siguresave ~ 25 A si dhe blerjen e materialeve, Siguresa komplet 25 A dhe te ndryshmeve qe lidhen me kete proces .Ky çmim i referohet 1 cope

- **F.V. shtylla ndricimi** - Ky çmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per vendosjen e shtyllave metalike H=9m, kod PAICC-3 ,blerjen e materialeve te tjera tub pvc

315 mm ,Beton C - 16/15 për fiksime dhe te ndryshme qe nevojiten per vendoshjen e tyre,transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, vibrimin dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjehere me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit. Ky cmim i referohet 1 cope.

- **F.V. krah shtylla ndricimi** - Ky cmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per vendosjen e kraheve te shtyllave te ndricimit,blerjen e materialeve te nevojshme ,krah shtylle e te tjera te nevojshme si dhe makineri (vinc) . Ky cmim i referohet 1 cope

- **F.V. ndricues** - Ky cmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per vendosjen e ndricuesve si dhe blerjen e materialeve te nevojshme per te ndricues smart,llampe me natrium tubolare ,dhe makineri (vinc) . Ky cmim i referohet 1 cope

- **F.V. pusete plastike ndricimi** - Ky cmim perfshin teresine e punes qe nevojitet per vendosjen e pusetave palstike ,blerjen dhe transportin e materialeve te ndryshme ,pusete plastike 40x40x40me kapak të fortë RIC ,beton C - 16/150 për fiksime dhe te tjera. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjehere me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit. Ky cmim i referohet 1 cope.

- **Shtrese rere mbi dhe nen tubacion plastik** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve qe lidhen me blerjen e materialit te reres, te puntorise per hedhjen ne veper, shtrirjen me trashesine dhe pjerresine e kerkuar, ngjeshjen me kujdes te shtreses poshte, anash dhe mbi tubat plastike me trashesi 10 cm sipas projektit dhe kushteve teknike . Ne cmim perfshihet ngarkimi, transporti, shkarkimi i materialit ne objekt dhe ngjeshja me kujdes e reres me qellim qe tubat te mos demtohen nga agjentet mekanike. Ky cmim i referohet 1 m³.

- **Mbushje me dhe** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhen me mbushjen e kanaleve me zhavorr ne thellesine e dhene ne profilet terthore te projektit, pas vendosjes se tubave plastike si dhe ngjeshjen e zhavorrit mbi tuba me shtresa ne cdo 20 cm. Gjithashtu ketu duhet te futet edhe kostoja e blerjes/prodhimit, ngarkimit, transportit, shkarkimit, te materialeve te nevojshme. Ky cmim i referohet 1 m³.

- **Germim kanali shk.ujra te bardha** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorine qe lidhet me germimin e dheut ne cfaredo lloj toke,makineri apo me krahe, per hapjen e kanaleve ku do te shtrihen tubot e shkarkimit te ujrave te shiut me thellesine e percaktuar ne profilat gjatesore te projektit. Ky cmim perfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen ne vendet e autorizuar per depozitim e materialeve te teperta te evaduar. Ky cmim i referohet 1 m³ germim.

- **Mure buto betoni C 16/20** - Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe puntorise qe lidhet me blerjen e betonit ose te materialeve te nevojshme (si rere, granil, cemento, gure,armature dhe cdo gje tjeter) ndertimin e murit buto betonit M-150 ,pergatitjen e armaturave , transportin, shkarkimin, hedhjen ne veper, vibrimin dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimim e ketij zeri sipas projektit. Betonet duhet jene me granil dhe rere te lare dhe asnjehere me zhavorr lumi, dhe me permasa qe specifikohen ne vizatimet e projektit. Ky cmim i referohet. 1 m³.

- **F.V.tuba p.v.c. d=200 mm** - Ky cmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me blerjen apo prodhimin e materialeve te nevojshme (si tuba p.v.c. d=200 mm, zhavorr, dhe cdo gje tjeter), shtrirjen e tubave per shkarkimin e ujrave te shiut sipas profilit te dhene ne projekt mbi shtresen e reres me trashesi 10 cm, ngjitja e

d=200 mm, zhavorr, dhe cdo gje tjeter), shtrirjen e tubave per shkarkimin e ujrave te shiut sipas profilit te dhene ne projekt mbi shtresen e reres me trashesi 10 cm, ngjitja e tyre me ngjtese sintetike hidroizoluese apo lidhja me te njejten ngjtese e gotave me kokat e tubave, kostoja e blerjes se ketyre materialeve dhe çdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per funksionimin e kanalizimit, te gjitha keto konform vizatimit tip shoqerues ne projekt si dhe ngarkimin, transportin, shkarkimin e te gjitha materialeve te permendura me siper, largimin e materialeve te teperta ne pikat e autorizuar nga autoritetet lokale per hedhjen e mbeturinave ndertimore, dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimin e ketij zeri sipas projektit. Ky çmim i referohet 1 ml.

- Shtrese rere mbi dhe nen tubacion plastik - Ky çmim perfshin teresine e punimeve qe lidhen me blerjen e materialit te reres, te puntorise per hedhjen ne veper, shtrirjen me trashesine dhe pjerresine e kerkuar, ngjeshjen me kujdes te shtreses poshte, anash dhe mbi tubat p.v.c. me trashesi 10 cm sipas projektit dhe kushteve teknike . Ne çmim perfshihet ngarkimi, transporti, shkarkimi i materialit ne objekt dhe ngjeshja me kujdes e reres me qellim qe tubat te mos demtohen nga agentet mekanike. Ky çmim i referohet 1 m³.

- Ndertim puseta me zgare gize per ujrane shiut - Ky çmim perfshin teresine e puntorise dhe punimeve qe lidhen me germimin, mbushjen dhe ngjeshjen e dheut, pregatitjen/blerjen e betonit M 200, konstruksionit mbajtes te kapakut, kapakut te gizes 35x35 cm te parapregatitur, hedhjen e betonit ne veper per ndertimin e mureve te pusetes me trashesi 15 cm, vendosjen e tyre ne veper, hedhjen e nje shtrese betoni M 200 me trashesi 10 cm ne fundin e pusetes, rakordimin me tubat e largimit te ujrave te bardha, ngarkimin, transportin, shkarkimin, e ketyre materialeve dhe evadimin e materialeve te teperta ne vendet e autorizuar nga autoritetet lokale dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimin e pusetes sipas vizatimeve te projektit. Ky çmim i referohet 1 cope.

PUNOI
ZYRA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

SHKURT 2016